



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E FINANCAVE  
NJËSIA QËNDRORE E HARMONIZIMIT TË  
MENAXHIMIT FINANCIAR DHE KONTROLLIT

Nr. 600 Prot.

Tiranë... 16.03.2011

Për: Institucionin \_\_\_\_\_

**Subjekti: Hapat që duhen ndjekur nga njësitë publike për implementimin e Ligjit Nr.10296, datë 8.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin"**

Ligji Nr.10296, datë 08/07/2010, "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", i cili ka hyrë në fuqi më 1 Janar 2011, përcakton disa detyrime për tu përmbushur nga të gjitha Njësitë Publike. Me anë të kësaj shkrese sjellim në vëmendjen Tuaj hapat që duhen ndjekur në zbatim të Ligjit të lartpërmendur, me qëllim përmirësimin e sistemeve të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit në të gjitha nivelet e njësisë publike (organi qendror dhe njësitë e vartesisë).

1. Rishikimi i strukturave menaxheriale, për të reflektuar përgjegjshmërinë menaxheriale të aktorëve kryesorë të njësisë publike, si Titullari, Nëpunësi Autorizues, Nëpunësi Zbatues dhe Menaxherët e tjerë. Vecanerisht të rishikohet përgjegjshmeria menaxheriale dhe linja e raportimit të Nëpunësit Zbatues sipas kërkesave të ligjit. Neni nr.8 i ligjit specifikon përgjegjësitë e Titullarit, nenet 9, 11 dhe 12, listojnë përgjegjësitë menaxheriale, linjën e raportimit dhe rastet e delegimit të të drejtave dhe detyrave, përkatesisht të nëpunësve autorizues, të menaxherëve të tjerë dhe të nëpunësve zbatues.
2. Caktimi i Koordinatorit të Riskut, bazuar në nenin 10 të Ligjit.
3. Krijimi i Grupit të Menaxhimit Strategjik në nivelin qendror të njësisë publike (GMS) sipas nenit 27 të ligjit me përbërje menaxherët e nivelit më të lartë të institucionit (njëkohësisht dhe drejtues të programeve buxhetore), si dhe nëpunësin zbatues të njësisë publike. Aktualisht në Ministrinë e linjës funksionojnë Grupet për Strategji Buxhet dhe Integrim, emërtimi i të cilave do të ndryshojë në GMS (Grupe të Menaxhimit Strategjik) me përbërjen dhe funksionet sipas ligjit, duke përfshirë dhe detyrimet e vendosura me Urdhër të Kryeministrit Nr.78, datë 8.05.2006. Nëpunësi Zbatues i Njesise Publike ofron shërbimin e sekretariatit të GMS.
4. Përcaktimi i strategjisë afatmesme të menaxhimit të risqeve prioritare që pengojnë realizimin e objektivave kryesore të njësisë publike, në të njëjtën kohë dhe në linjë me hartimin e Planit të Buxhetit Afatmesëm, dhe miratimi nga GMS. Neni 21 i ligjit hedh bazat për menaxhimin e riskut.
5. Miratimi nga GMS i planit të veprimit afatmesëm për rishikimin e sistemeve të brendshme të kontrollit të të gjitha niveleve të njësisë publike dhe përgatitjen e

gjurmëve të auditit për procedurat specifike të institucionit, bazuar në kërkesat e Kreut III të ligjit.

6. Caktimi nga Titullari i procedurave të brendshme të antikorrupsionit dhe sinjalizimit të parregullsive në referencë të nenit 8, pika 8 (e) dhe nenit 17 të ligjit.
7. Në lidhje me shfuqizimin e Ligjit Nr.6942, datë 25.12.1984 dhe akteve nënligjore që lidhen me të, sqarojmë se Ministria e Financave po harton procedurat standarde për menaxhimin e aktiveve të njësive publike. Bazuar në Nenin 33 të Ligjit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, deri në daljen e këtij Udhëzimi, do të zbatohet kuadri ligjor dhe nënligjor egzistues, për sa nuk bie në kundërshtim me ligjin për MFK-në.
8. Në përfundim të çdo viti buxhetor, duke filluar nga fundviti 2011, hartimi nga Nëpunësi Autorizues i njësive publike i Deklaratës vjetore për cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontrolleve të brendshme, sipas nenit 18 të ligjit.
9. Gjatë punës për implementimin e kërkesave të Ligjit për MFK-në rekomandohet referimi në Manualin e Ministrisë së Financave “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” miratuar me Urdhër Nr.54, datë 15.07.2010 të Ministrit të Financave. Ky Manual është dërguar tek të gjithë Nëpunësit Autorizues të njësive publike dhe gjendet gjithashtu në faqen e internetit të Ministrisë së Financave [www.minfin.gov.al](http://www.minfin.gov.al) nën emërtimin ‘Produktet e Njësive Qendrore e Harmonizimit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin’.

Gjatë vitit 2011, Ministria e Financave do të nxjerrë udhëzime të veçanta për: gjurmët standarde të auditit për proceset e unifikuara të planifikimit, zbatimit, monitorimit të buxhetit dhe menaxhimit të aktiveve; për ndërtimin dhe funksionimin e sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit, ku përfshihet dhe mënyra e funksionimit të Grupit të Menaxhimit Strategjik (GMS); formën dhe përmbajtjen e deklaratës vjetore të cilësisë së sistemeve të kontrollit të brendshëm; etj.

Ridvan BODE



MINISTER